



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502019/2

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Rekomandojmë dhënien e dyfishit të pagesës për shkak të verbërisë për nxënësin XH.T*

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë

DEVOLL

I Nderuar Kryetar,

Pranë institucionit të Avokatit të popullit ka paraqitur ankesë qytetari Xh. T, banues në Bashkinë Devoll. Aktualisht ky qytetar është nxënës në shkollën e mesme Asim Vokshi në Tiranë.

Në ankesën e tij ai sqaron se është përfitues nga Statusi i të Verbërit, grupi i II dhe si përfitues nga ky Status, ai gjatë vazhimit të studimeve në shkollën e mesme, duhet të përfitojë dyfishin e pagesës që përfiton për shkak të verbërisë. Ai gjithashtu sqaron, se këtë vit ka filluar studimet në shkollën e mesme Asim Vokshi, por para këtij viti shkollor, për dy vite me rradhë ka studjuar pranë vendit të tij të banimit, në klasën e dhjetë në të cilën nuk ka arritur të jetë kalues. Gjatë vitit arsimor 2015-2016 ai nuk po e përfiton dyfishin e pagesës për shkak të verbërisë pranë Bashkisë Devoll. Kjo me arsyetimin se po përsërit për herë të tretë klasën e dhjetë.

Për sa më sipër ju sqarojmë se:

Nxënësi Xh. T. është përfitues nga Statusi i të Verbërit sipas Ligjit 8098 datë 28.03.1996, i cili në nenin 8 parashikon:

“Arsimimi i të verbërve në sistemin shtetëror bëhet falas, kurse pranimi i tyre në arsimin e zakonshëm bëhet me kriterë të veçanta të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Gjatë kohës së studimit në arsimin e mesëm, universitar

ose pasuniversitar, si dhe gjatë periudhës së kualifikimit, të verbërit përfitojnë pagesën e vendosur nga Këshilli i Ministrave. Ata me gradë shkencore këtë pagesë e përfitojnë në mënyrë të përhershme. Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e të verbërve”.

Gjithashtu në VKM 277 datë 18.06.1997 i ndryshuar, “Për përfitimet nga Statusi i të verbërit”, në pikën 7 parashikohet:

“Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurse kualifikimi, përfitojnë dyfishin e pagesës për shkak të verbërisë, kurse studentët e shkollave të larta dhe ata që janë përfshirë në studimet pasuniversitare, si dhe kanë mbrojtur gradën doktor i shkencave, përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi. Keto pagesa do të bëhen vetëm kur vazhdimi i shkollave ose i kurseve vërtetohet nga titullarët e shkollave të mesme apo të larta dhe jo më shumë se një vit nga cikli normal i studimit. Pagesa për shkak të gradës shkencore është e përhershme dhe bëhet mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente. Fondet për këtë pagesë transferohen nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale pranë institucionit përkatës ku ndodhet përfituesi, mbasi të jenë plotësuar praktikat përkatëse dhe të jenë konfirmuar nga Kryesia e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë”.

Nga kjo dispozitë duket qartë se personi përfitues nga Statusi i të verbërit, këtë pagesë e përfiton jo vetëm për një shkollë të mesme, por edhe nëse do të parashikohej kështu, kjo dispozitë më poshtë parashikon se kjo pagesë përfitohet edhe një vit shkollor më shumë se sa zgjat cikli normal i studimeve. Në këtë rast qytetari këtë e ka vitin e tretë që përfiton dyfishin e pagesës për shkak të verbërisë, ndëkohë që vetëm cikli normal i një shkolle të mesme zgjat 3 vjet.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se: "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Përfitimin e dyfishit të pagesës së grupit të invaliditetit për shkak të verbërisë për vitin arsimor 2015-2016, bazuar në VKM Nr.277 datë 18.07.1997 i ndryshuar, “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një

rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI